Shqiperia humbet 10 vende

nga Administrator
E martë, 12 Prill 2016 23:01

Kombetarja jone ka humbur plot 10 pozicione ne renditjen e FIFA-s, duke u renditur ne vendin e 45. Kjo zbritje e ekipit tone vjen si rezultat i humbjes kunder Austrise si edhe mungeses te zhvillimit te ndeshjeve miqesore kunder ekipeve me koeficent te larte. Ne muajin e fundit Shqiperia ka marre 172,26 pike te cilat kane ardh si rezultat te fitores kunder Luksemburgut. Kurse humbja kunder Austrise nuk ka sjelle asnje pike. Gjithashtu rol ne humbjen e 10 pozicioneve eshte edhe rezultatet e mira qe kane bere kombetaret e tjera. Me date 5 maj do te publikohet renditja e FIFA, por kombetarja jone eshte e sigurte qe nuk mund te permiresoje renditjen pasi ne kete periudhe nuk do te luaje asnje ndeshje miqesore.